

V E N D I M

Nr.326, datë 21.6.1993

PER KRITERET E TRAJTIMIT TE INVALIDEVE TE LUFTES KUNDER PUSHTUESVE NAZIFASHISTE TE POPULLIT SHQIPTAR

Në zbatim të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", me propozimin e Minsitrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Personit i lind e drejta të njihet si invalid i luftës, kur paraqet këto dokumente:
 - a) Librezën e pensionit të invalidit të luftës ose të pensionit të pleqërisë, kur në të është llogaritur edhe shtesa si invalid i luftës.
 - b) Vërtetimet zyrtare të lëshuara nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, degët ushtarake, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit e spitalit ushtarak, si dhe çdo akt tjetër zyrtar që vërteton plagosjen a gjymtimin në kushtet e parashikuara në nenin 1 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993.
 - c) Kur nuk ka dokumente zyrtare, plagosja a gjymtimi në luftën kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar vërtetohet në rrugë gjyqësore, sipas dispozitave në fuqi.
2. Qenia invalid, grupi përkatës dhe ndryshimi i grupit të invaliditetit përcaktohen nga Komisioni mjekësor i caktimit të aftësive për punë, mbi bazën e kërkesës së të interesuarit ose të degëve të sigurimeve shoqërore, sipas kriteve të ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".
3. Invalidit të luftës i jepet një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit në masën:

- Për grupin e parë të invaliditetit 4000 lekë
- Për grupin e dytë të invaliditetit 3500 lekë
- Për grupin e tretë të invaliditetit 3000 lekë
- Për grupin e katërt të invaliditetit 2500 lekë

Këtë shtesë invalidi i luftës e merr edhe kur del në pension pleqërie. Kjo shtesë do të ndryshojë në të njëjtën masë me ndryshimin e pagave dhe pensioneve.

4. Personi i ngarkuar sipas vendimit të KMCAP-së për t'i shërbyer invalidit të luftës të grupit të parë merr pagën bazë të caktuar në klasën II të lidhjes nr.II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 (pa përfutur shtesat e tjera), që paguhet nga bashkitë ose komunat.

5. Shpenzimet për barnat e kurimet falas të përballohen për vitin 1993 nga fondet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.247, datë 27.5.1993, kurse ato për transportin falas dhe me gjysmë pagese të mbulohen nga diferencat e çmimeve të planifikuara për transportin urban për vitin 1993.

6. Shoqata e invalidëve të luftës për vitin 1993 të financohet me 400 mijë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në buxhetin e shtetit për vitin 1993.

7. Dëshmia e invaliditetit lëshohet nga kryesia e shoqatës dhe seksioni i financës i vendbanimit të invalidit. Ajo përmban gjeneralitetet e invalidit, fotografinë e tij dhe të drejtat që ai gëzon të përcaktuara në ligj. Kur invalidi vdes, dëshmia e tij i dorëzohet organit drejtues të shoqatës.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe organet e pushtetit lokal.
9. Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1993 i shtohen 13 milionë lekë, që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në buxhetin e shtetit për vitin 1993.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar".

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI